EUred

REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIKA E KOSOVËS
OPŠTINA KLOKOT / KOMUNA E KLLOKOTIT
Nr. 1528) 2 Dt. 14. 10. 2011
KLOKOT / KLLOKOT

# KOMUNA KLOKOT

## STRATEGJIA PËR ZHVILLIM TË NDËRMARRJEVE TË VOGLA DHE TË MESME DHE NDËRMARRËSISË NË KOMUNËN E KLLOKOTIT PËR PERIUDHËN 2011-2016

Ky Publikim është krijuar me asistencën e Unionit Europian. Përmbajtja e këtij publikimi është përgjegjësi e vetme e kontraktuesit SPARK dhe nuk mundet të merret në asnjë mënyrë që pasqyron qëndrimet e Unionit Europian

Gusht, 2011

Projekt financuar nga ben Zyra Ndërlidhës e Komisionit Europian

Implementuar nga spark ignites ambition në partneritet Fractal

PËRMBAJTJA


1 **Flajët hyrëse** ........ 2

2 **Analiza socio-ekonomike e komunës** ........ 3

2.1 Të dhëna te përgjithshme dhe pasuritë natyrore ........ 4

2.2 Karakteristikat demografike ........ 6

2.3 Infrastruktura ........ 8

2.4 Zhvillimi lokal ekonomik ........ 9

3 **Analiza e gjendjes në sektorin e ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme dhe në sektorin e ndërnarrësisë** ........ 10

3.1 Analiza e sektorit të ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme dhe të ndërmarrësisë në territorin e Kosovës ........ 10

3.2 Analiza e sektorit të ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme dhe të ndërmarrësisë në territorin e Kllokotit ........ 13

4 **Analiza "PEST"** ........ 16

4.1 Faktorët politik the ligjor ........ 16

4.2 Faktorët ekonomik ........ 17

4.3 Faktorët shoqëroro-kulturor ........ 17

4.4 Faktorët teknologjik ........ 18

5 **Analiza SWOT për sektorë të ndryshëm ekonomik** ........ 19

5.1 Prodhimet bujqësore ........ 19

5.2 Prodhimi dhe ambalazhimi i ujit mineral ........ 21

5.3 Zhvillimi i turizmit në banja ........ 23

5.4 Përpunimi i drurit ........ 24

6 **Vizioni dhe misioni i komunës në fushën e NVM-ve dhe të ndërmarrësisë** ........ 26

7 **Qëllimet strategjike të zhvillimit të NVM-ve** ........ 27

8 **Vërrejtjet përmbyllëse** ........ 28

9 **Pjesëmarrësit në punëtori** ........ 29

10 **Propozim plani aksional për implementimin e strategjisë zhvillimore NVMS në komunën e Kllokotit, për vitet 2011-2016** .. 30

## 1. Fjalët hyrëse

Draft strategjia për zhvillimin e ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme dhe të ndërmarrësisë në Komunën e Kllokotit është bërë në kuadër të projektit „Ngritja e potencialit ekonomik në komunën e Novobërdës, Kllokotit, Ranillugut dhe Shtërpces" që financohet nga Bashkimi Evropian, ndërsa menaxhohet nga Zyra Ndërlidhëse e Komisionit Evropian. Projekti implementohet nga organizata SPARK nga Holanda në bashkëpunim me organizatën Fraktal.

Projekti ka për qëllim krijimin e kushteve më të mira për zhvillimin dhe përkrahjen e ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme në fushat e targetuara dhe është pjesë e projektit për zhvillim rajonal ekonomik.

Ky draft i dedikohet grupeve të interesit në vazhdim: ndërmarrësve, personave juridik, banorëve të komunës së Kllokotit, anëtarëve të kuvendit komunal të komunës së Kllokotit, investitorët potencial, donatorët, akteret në fushën e sektorit jo-qeveritar, sektorit profesional dhe të gjithë të tjerëve për të cilët ky draft mund të shërbejë si një udhëzues i mirë për investime si dhe për analiza të ndryshme ekonomike.

Qëllimi i draftimit të kësaj strategjie për zhvillimin e ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme dhe të ndërmarrësisë, është identifikimi i porencialit ekonomik në komunën e Kllokotit si dhe udhëzimi i investimeve në fushat që janë në interes dhe në pajtim me përparësitë e këtij territori, si dhe me mundësit që ky territor i ofron për ngritjen e nivelit të aktiviteteve prodhuese. Përveç kësaj, kjo strategji e komunës së Kllokotit ka për qëllim krijimin e një ambienti prodhues me qëllim të krijimit të një sektori dinamik, konkurrues dhe të orientuar në eksport të ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme dhe të ndërmarrësisë. Qëllimet e definiuara në këtë mënnyrë janë në pajtim me mundësitë reale dhe me potencialet njerëzore dhe natyrore të këtij territori.

Efekti i pritur ekonomik dhe shoqërorë pas formulimit dhe implementimit të suksesshëm të strategjisë për zhvillimin e sektorit të NVM-ve dhe të ndërmarrësisë do të reflektojë në ngritjen e punësimit, ngritjen e standardit jetësorë të banorëve, ngritjen e kushteve materiale për arsimim, në përmirësimin e shëndetësisë dhe fushave tjera të rëndësishme shoqërore, krijimin e kushteve në treg për eksport, efekt pozitiv në bilancin e pagesave, ngritjen e aktiviteteve për investime të reja dhe ndodhi të reja shoqërore. Është më se e rëndësishme të theksohet që si rezultat i zbatimit të suksesshëm të kësaj strategjie do të jetë edhe tejkalimi i dallimeve shoëroro-kulturore ndërmjet banorëve dhe e gjith kjo do të arrihet si pasojë e bashkëpunimit intenziv në fushën e biznesit.

Në kontekst të burimeve të kufizuara financiare, strategjia do të përqëndrohet në një numër të vogël të prioriteteve me qëllim të drejtimit të investimeve të mundshme në fushat e caktuara. Do të ndahen prioritetet në fusha të caktuara, të paraqesin përparësi krahasuese të komunës së Kllokotit dhe do të bëhen analiza të përparësisë, mangësisë, mundësisë dhe të kufizimeve të këtyre fushave të caktuara.

Zhvillimi i sektorit të NVM-ve dhe ndërmarrësisë në komunën e Kllokotit duhet të bazohet në modelin që do të sigurojë qëndrueshmëri dhe që ne vete përfshin tri elemente kryesore:

1. analizën strategjike

2. zgjedhjet strategjike dhe
3. implementimin e strategjisë

Faza e parë paraqet *analizimin e situatës* në të cilën gjendet sektori i NVM-ve dhe ndërmarrësisë në komunën e Kllokotit. Projekt strategjia kryesisht do të merret me analizë strategjike në mënyrë që të identifikohen fuqite dhe mangësitë sa më mirë që është e mundur. Përveç analizës së mjedisit, rezultat i veprimit në këtë fazë të planifikimit strategjik është definimi i vizionit, misionit dhe qëllimeve strategjike në fushën e zhvillimit të NVM-ve dhe ndërmarrësisë në komunën e Kllokotit. Në këtë mënyre mund të arrihet në fazën e rradhës që përfaqëson fazën e zgjedhjes dhe selektimit të strategjisë. Figura 1.1 tregon këtë model të planifikimit strategjik.




*Figura 1.1* – Koncepti i planifikimit strategjik

*Zgjedhja strategjike* nënkupton aktivitetet e definimit të vlerave strategjike, identifikimin e drejtimeve të ndryshme strategjike dhe vlerësimin dhe përzgjedhjen e strategjive optimale. Faza e fundit ëshë *zbatimi i strategjisë* dhe kjo është faza kryesore për arritjen e përparësive të qëndrusheme konkurruese të komunës. Nënkupton, akvizimin e organizatës, alokimin e burimeve dhe kontrollimin dhe menaxhimin e ndryshimeve strategjike. Zbatimi i strategjisë bëhet përmes realizimit të planeve të ndryshime të aktiviteteve që do të draftohen nga komuna e Kllokotit dhe që kanë për qëllim jetëzimin e vizionit të definuar, misionit dhe qëllimeve.

Draft strategjia për zhvillimin e ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme dhe të ndërmarrësisë është përgatitur nga z. Vladimir Djenopoljac nga Fakulteti Ekonomik në Kragujevac. Drafti është punuar si pasojë e punëtorive në të cilat pjesëmarrës kanë qenë përfaqësues të udhëheqësisë komunale dhe përfaqësues të ndërmarrjeve aktive në territorin e komunës së Kllokotit. Përveç të lartëpërmendurve, në këtë strategji kanë kontribuar edhe përfaqësues të

Qendrës për Shërbime të Biznesit në Kosovë si dhe përfaqësues të organizatës jo-qeveritare „Fraktal".

## 2. Analiza socio-ekonomike e komunës

Analiza socio-ekonomike e komunës së Kllokotit përfshin disa fusha të rëndësishme. Fillimisht, do të tregohen të dhëna të përgjithshme për komunën si dhe për pasuritë natyrore që ajo i posedon. Kjo do të ndihmojë analizën e mëtutjeshme në identifikimin e përparësive komparative në bazë të cilës do të zhvillohen përparësia konkurruese në të ardhmen. Pastaj, do të analizohen karakteristikat demografike të komunës. Kjo bëhet më qëllim të identifikimit të pasurisë së komunës me kapital njerëzorë, si bartës të ndryshimeve dhe si implementues të strategjisë. Segmenti i tretë e analizës socio-ekonomike tregon për infrastrukturën komunale në aspektin e rezultateve të deri-tanishme dhe në bazë të planeve në të ardhmen. Rëndësia e infrastrukturës është se luan rrolin e një mbështetjeje fizike për realizimin e qëllimeve strategjike komunale dhe si parakusht i domosdoshëm në ngritjen e nivelit të prodhimit në territorin e analizuar. Pjesa e katërt do të fokusohet në paraqitjen e indikatorëve bazik të aktiviteteve prodhuese në territorin e Kosovës duke përfshirë territorin e komunës së Kllokotit. Ndërsa, segmenti i fundit nënkupton paraqitjen e karakteristikave bazike të zhvillimin ekonomik lokal në territorin e lartëpërmenduar. Kjo pjesë ka për qëllim që në mënyrë të përgjithësuar të paraqesë përparësitë dhe mangësitë e zhvillimit ekonomik lokal.

### 2.1 Të dhëna të përgjithshme dhe pasuritë natyrore

Komuna e Kllokotit është e vendosur në juglindje të Kosovës, në territor prej 2.336 ha. Është formuar në vitin 2009 në pajtim me Planin e decentralizimit i cili është implementuar si pjesë e „Propozimit gjithpërfshirës për zgjedhjen e statusit në Kosovë". Deri në Nëntor 2009 komuna ishte pjesë e komunës së Vitisë. Mbledhja inauguruese e kuventit komunal të komunës së Kllokotit është mbajtur me 8 Janar 2010.




*Figura 2.1 – Pozita gjeografike e komunës së Kllokotit në kuadër të territorit të Kosovës (*

Geografski položaj opštine Klokot u okviru teritorije Kosova (*burimi: Šta treba da sadrži profil zajednica u opštini Klokot, draft pune, 1 Prill 2011).*

Komuna është e përbërë nga katër fshatra, Kllokoti, Mogila, Vrbovci dhe Grncar-i. Pozita gjeografike e komunës është e paraqitur në Figurën 2.1, deri sa struktura e komunës së Kllokotit është e paraqitur ne Figurën 2.2.

Numri i përgjithshëm i banorëve që jetojnë në këtë komunë të posakrijuar është përreth 5.145. Nga ky numër i përgjithshëm, 3.710 janë Serbë nga Kosova, 1.340 janë nga entiteti Shqipëtarë, deri sa 95 janë të entitetit Romë. Struktura e banorëve në bazë të këtij kriteri është e paraqitur në Figurën 2.3.



*Figura 2.2* – Struktura e komunës së Kllokotit (Burimi: Ëikipedia)

Përparësitë komparative të komunës së Kllokotit në aspektin e burimeve natyrore, që do të jetë shtylla kryesore në përcaktimin e drejtimit të zhvillimit ekonomik në të ardhmen, përfshijnë tokë pjellore për të gjitha kulturat bujqësore si dhe pasuri të ujit termo-mineral. Këto dy përparësi komparative paraqesin pasuritë kryesore natyrore në territorin e Komunës. Përveç kësaj, në fshatin Grncar ekzistojnë dy gurëthyes që mund të luajnë rrol të rëndësishëm në fushën e furnizimit për industrinë e ndërtimit.

Prodhimi bujqësorë është sektori kryesorë i ekonomisë dhe shumica e banorëve merren me ndonjë lloj të prodhimit bujqësorë, përveç që ky prodhim është i copëtuar dhe shumica e produkteve finale shfrytëzohen për konsum personal (ky fakt do të tregohet si mungesë në analizat e mëvonshme), dhe kjo tregon për potencialin e krijimit të një shoqate të mundshme të prodhuesëve bujqësorë me qëllim të organizimit të çasjes në treg. Përparësia e dytë komparative e komunës (pasuria me ujë termo-mineral) shfrytëzohet në një masë të konsiderueshme, për shkak se në territorin e komunës së Kllokotit funksionojnë tri industri të ambalazhimit të ujit mineral të cilat punësojnë gjithsejt 80 punëtorë. Sektori ekonomik që del si pasojë e pasurisë së burimeve termo-minerale është organizimi i turizmit në banja. Në territorin e komunës funksionojnë dy vendpushime (Nëna Naile dhe Banja e Kllokotit) që punësojnë diku rreth 350 punëtorë. Numri i përgjithshëm i punëtorëve rritet gjatë sezonës kur punësohen një numër i konsiderueshëm i punëtorëve sezonal.




*Figura 2.3* – Struktura e banorëve sipas kriterit të përkatësisë etnike

Edhe pse dy pasuritë natyrore (toka e pjellshme dhe burimet termo-minerale) shfrytëzohen në nivel të mirë, ky nivel i eksploatimit është larg nivelit të zhvillimit që duhet të arrihet për ngritjen e konkurrences së qëndrueshme të kësaj zone në Kosovë. Në këtë mënyrë është më se e nevojshme të analizohen mundësitë shtesë të rritjes dhe zhvillimit të aktiviteteve prodhuese të bazuara në përparësitë krahasuese të lartëpërmendura. Me rritjen e zhvillimit të bujqësisë dhe eksploatimit të ujit (ambalazhimi dhe banjat), kjo zonë ka avantazhe të konsiderueshme në fushën e përpunimit të drurit, dhe ky segment do të analizohet nga aspekti i mundësisë së rritjes dhe zhvillimit në të ardhmën.

### 2.2 Karakteristikat demografike

Karakteristikat e përgjithshme demografike nënkuptojnë strutkturën e banorëve me bazë përkatësinë etnike, moshën, gjininë, si dhe nivelin e arsimimit të banorëve. Më lartë kemi treguar për numrin e përgjithshëm të banorëve në Komunën e Kllokotit (5.050 banorë). Lëvizja e atij numri në periudhën 1948 e deri më sot tregohet në Figurën 2.4 dhe 2.5.

Karakteristikat demografike janë të rëndësisë së veçantë për secilën komunë, para së gjithash burimet njerëzore janë bartësit e njohurive, të aftësuerit dhe mundësia për aftësim që në kohërat moderne përfaqëson shtyllën e konkurrencës në përgjithësi. Gjendja ekzistuese në tregun e fuqisë punëtore në komunën e Kllokotit tregon se situata është shumë e vështirë sa i përket çështjes së papunësisë (rreth 2.000 banorë në gjendje pune të papunësuar, deri sa prej tyre vetëm 435 janë të punësuar dhe në këtë numër vetëm 300 të punësuar pranojnë të ardhura minimale që paguhen nga Republika e Serbisë). Sidoqoftë, kjo mangësi mund të përfaqësojë edhe mundësi në të ardhmën për shkak të ekzistimit të potencialit në të cilin duhet investuar në përputhje me prioritetet ekonomike që do të identifikohen në këtë dokument.

| **Vendbanimi** | **1948.** | **1953.** | **1961.** | **1971.** | **1981.** | **1991.** | **2011.** |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| Vërbovc | 667 | 745 | 758 | 813 | 883 | 775 | 931 |
| Grncar | 374 | 447 | 456 | 516 | 523 | 477 | 729 |
| Kllokot | 714 | 783 | 940 | 1117 | 1223 | 1197 | 1540 |
| Mogila | 1339 | 1477 | 1439 | 1514 | 1520 | 1523 | 1850 |
| **Gjithsej** | **3.094** | **3.452** | **3.593** | **3.960** | **4.149** | **3.972** | **5.050** |

*Figura 2.4* – Lëvizja e numrit të banorëve në periudhën 1948-2011.




*Figura 2.5* – Trendi i lëvizjes së numrit të banorëve në periudhën 1948-2011

Përkatësia etnike e banorëve në komunën e Kllokotit është treguar në Figurën 2.3 në kuadër të paraqitjes së përgjithshme të profilit të komunës. Struktura e arsimuar e banorëve të komunës së Kllokotit është e treguar në Figurën 2.6. Është e rëndësishme të theksohet se në Figurën e lartëpërmendur paraqitet numri i banorëve të rexhistruar në sistemin Kosovar të arsimimit. Përveç kësaj, në sistemin e arsimimit fillor në këtë komunë janë të punësuar 95 banorë, prej të cilëve 21 të nacionalitetut Shqipëtarë dhe 74 të nacionalitetit Serb. Në sistemin e arsimimit të mesëm janë të punësuar 54 punëtorë të nacionalitet Serb, deri sa në këtë segment nuk është i punësuar asnjë i nacionalitet Shqipëtarë. Sa i përket sistemit të lartë të arsimimit (arsimimi terciar), ky sistem nuk është prezent në territorin e komunës së Kllokotit.




*Figura 2.6* – Numri i banorëve të rexhistruar në sistemin Kosovar të arsimimit

Struktura e paraqitur e arsimimit (Figura 2.6) nuk është e kompletuar për shkak të vështirësisë në gjetjen e informatave të detajizuara. Sidoqoftë, edhe kjo pasqyre tregon mjaftë për pozitën të numrit të banorëve të arsimuar. Duke pasë parasysh rëndësinë e mendimit për zhvillim afatgjatë të komunës, e rëndësishmë është çasja në këtë Strategji për të investuar në sektorin e arsimimit në të ardhmën.

Ka mungesë të të dhënave sa i përket strukturës gjinore, sidoqoftë, do të marrim shembull të dhënat për strukturën gjinore në Kosovë ku raporti mashkull / femër paraqitet si në të dhënat në vijim (vlerësimi në vitin 2011, burimi: *CIA Factbook 2011*):

- Në lindje: mashkull / femër 1,085
- Nën 15 vjet: mashkull / femër 1,09
- Prej 15 deri 64 vjet: mashkull / femër 1,09
- Përtej 65 vjet: mashkull / femër 1,06

Në kontekstin e strukturës së moshës të banorëve,

U kontekstu starosne struktura stanovništva, do të aplikojmë metodën e njejtë si në rastin e strukturës gjinore. Si pasojë, struktura e moshës duket si në vijim (Figura 2.7):

- Mosha 0 deri 14 vjet: 27,2%
- Mosha 15 deri 64 vjet: 66,1%
- Përtej 65 vjet: 6,7%




*Figura 2.7* – Struktura e moshës (në pajtim me strukturën e moshës në Kosovë)

Struktura e paraqitur e banorëve në bazë të moshës dhe relacionit mashkull / femër mund të vlerësohet si e volitshme për shkak të numrit të madh të të rinjëve që mund të jenë bartës të ndryshimeve në të ardhmën.

### 2.3 Infrastruktura

Në fushën e transportit rrugor është e rëndësishmë të tregohet që komuna e Kllokotit gjendet në magjistralen që lidh dy qendra të mëdha në Kosovë, Ferizajin dhe Gjilanin. Rëndësia e kësaj magjistraleje është edhe pse bën ndërlidhjen e autostradës Beograd – Shkup me autostradën për Prishtinë. Përveç pozitës së mirë në fushën e transportit rrugor, në vetë territorin e komunës është investuar vazhdimisht në përmirësimin e gjendjes së transportit rrugor. Në të ardhmën planifikohet që një shumë e konsiderueshme nga buxheti i komunës të ndahet për këto qëllime.

Sa i përket rrjetit të hekurudhave, stacioni më i afërt i trenit gjendet 18 km larg komunës në Komunën e Ferizajit. Lidhja me aeroporte është relativisht e mirë duke pasë parasysh që aeroporti i Sllatinës (në Prishtinë) dhe aerporti i Shkupit janë relativisht afër. I pari gjendet 45 km ndërsa i dyti 60 km larg. Portet më të afërta detare janë në Shqipëri dhe në Mal të Zi kështu që kjo formë e transportimit nuk është e rëndësishmë.

Sa i përket furnizimit me energji elektrike, në komunë është i vendosur trafo-stacioni për energji të lartë prej 35.000 voltëve. Telekomunikacioni është në nivel të kënaqshëm të zhvillimit. Mbulimi nga operatorët mobil është i mirë në gjithë territorin e komunës së Kllokotit. Shërbimet e internetit dhe telefonia fikse është në nivel të kënaqshëm dhe të mjaftueshëm për kërkesat momentale.

Furnizimi me ujë është në nivel të knaqshëm dhe mbulueshmëria është më e lartë se 80%. Në gjithë territorin e komunës janë ndërtuar 65% të rrjetit të kanalizimit në 2 vitet e fundit dhe është më se i rëndësishëm ndërtimi dhe modernizimi i kolektorëve ekzistues për trajtimin e ujit sipas standardeve të përgjithshme.

### 2.4 Zhvillimi lokal ekonomik

Problemet kryesore ekonomike në komunën e Kllokotit mund të përshkruhen si në vijim: mungesa e kushteve financiare për investim në asete fikse dhe lëvizëse, mungesa e interesimit për prodhim të produkteve vendore si dhe për fillimin e bizneseve personale nga ana e banorëve, çasja e ulët në tregjet jashtë mjediseve komunale, kushtet e pafavorshme te kreditimeve financiare nga institucionet ekzistuese financiare (të bankave në rradhë të parë), zvogëlimi i numrit të turistëve në banjat shëruese për shkak të situatës ekzistuese politike që reflekton imazhin e komunës me nivel të ulët të sigurisë, numri i vogël i aktiviteteve investuese dhe mungesa çasjës afatgjate të orientimit në punësim, mungesa e të hyrave komunale nga NVM-të dhe ndërmarrësia dhe numri i lartë i papunësisë.

Disa prej aktiviteteve kyçe të komunës në aspektin e tejkalimit të problemeve ekonomike janë bashkëpunimi i mirë i organeve lokale me sektorin privatë (komunikimi, inkurajimi i zhvillimit të sektorit të Ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme dhe ndërmarrësisë nga ana e komunës, fokusimi në sektoret prioritare dhe motivimi i orientimit afatgjatë të ndërmarrësve për të bërë biznes, përmirësimi i të gjitha formave të infrastrukturës, ngritja e nivelit të informimit të banorëve për të gjitha sferat e përkrahjes së ofruar nga organet lokale të udhëheqësisë dhe në sferën e zhvillimit të ndërmarrjeve të vogla në territorin e komunës.

Grupet kryesore të interesit në konekstin e zhvillimit lokal ekonomik janë ministritë, sektori privat, investitorët potencial dhe donatorët, organizatat jo-qeveritare. Rroli kryesorë i ministrive është në stimulimin e zhvillimit ekonomik në pajtim me parimin e shfrytëzimit adekuat të avantazheve krahasuese, në kuptimin që duhet të investohet më shumë në degët e rëndësisë afatgjate me qëllim të zhvillimit të komunës (shembull në ato sfera dhe degë që në këtë Draft janë të identifikuara si prioritet). Përveç kësaj, ministritë duhet të fokusohen në lehtësimin kushteve për burime financiare për sektorin privat.

Rroli i sektorit privat pasqyrohet në formë të marrëdhënjes aktive ndaj zhvillimit lokal ekonomik, intensifikimin e komunikimit me komunën, ndërtimin e një biznesi të shëndoshë me vizion të qartë dhe me strategji të rritjes dhe zhvillimit, promovimin e parimeve të shëndosha të ndërmarrësisë në të cilat do të bazohen anëtarët e rinj dhe ekzistues të sektorit të NVM-ve, në territorin e komunës së Kllokotit.

# 3. Analiza e gjendjes në sektorin e ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme dhe në sektorin e ndërmarrësisë

Ndërmarrjet e vogla dhe të mesme dhe ndërmarrësia përfaqësojnë fuqine kryesore të zhvillimit të të gjitha ekonomive kombëtare. Duke ngritur numrin e ndërmarrjeve të vogla, që në ciklin e vet jetësorë transformohen në ndërmarrje të vogla dhe të mesme, ngritet numri i taksa-paguesëve dhe intensifikohet ngritja ekonomike në përgjithësi. Kjo pjesë e Draftit të strategjisë përbëhet nga pjesë që do të tregojnë për gjendjen e sektorit të ndërmarrësisë në territorin e Kosovës dhe nga pjesë që do të pasqyrojnë gjendjen e këtij sektori e që është karakteristike për komunën e Kllokotit.

## 3.1 Analiza e sektorit të ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme dhe të ndërmarrësisë në territorin e Kosovës

Skektori i ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme dhe i ndërmarrësisë në Kosovë vlerësohet si një instrument i rëndësishëm i ngritjes së nivelit të të punësuarëve, bruto produktit shoqërorë dhe standardit jetësorë në përgjithësi. Për këtë arsyje në Kosovë është krijuar Agjencia për përkrahje të ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme në vitin 2006 si shtyllë e rëndësishmë për promovimin dhe zhvillimin e këtij sektori.

Në kuadër të Planit të Kosovës për Zhvillim (Kosovo Development Plan), dy objektivat kryesore në fushën e zhvillimit të Kosovës janë që kontributet e rritura të ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme rrisin bruto prodhimet në shoqëri, si dhe zvoglojnë nivelin e papunësisë. Në mënyrë që Kosova të përmbush kërkesat që parashtrohen nga proceset e mundshme integruese në Bashkimin Evropian, është e rëndësishmë të arrihet konkurrenca ekonomike, të rritet numëri i të punësuarëve, të promovohen aktivitetet dhe ndërmarrësia inovative si dhe të promovohet qëndrimi i shëndoshë ndaj biznesit dhe ndërmarrësisë, të promovohet kohezioni shoqëroro-ekonomik, dhe pozicionimi pro internacionalizimit të biznes-bërjes.

Në bazë të ligjeve ekzistuese, sektori i ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme dhe i ndërmarrësisë në Kosovë për nga madhësia klasifikohet si në vijim (Ligji Nº3/L-031, 17 Tetor 2008):

- Mikro ndërmarje – numri i të punësuarëve më i vogël se 10
- Ndërmarrje të vogla – numri i të punësuarëve prej 10 deri 49
- Ndërmarrje të mesme – numri i të punësuarëve më i vogël se 250

Siq mund të shihet nga më lartë, kategorizimi bëhet vetëm përmes numrit të punësuarëve deri sa në bazë të ligjeve të BE-së, përveç numrit të të punësuarëve duhet marrë parasysh edhe të ardhurat e përgjithshme si dhe asetet e subjektit ndërmarrës. Përveç pyetjeve të përgjithshme dhe mjedisit për bërjen e biznesit, është më se i rëndësishëm vrojtimi i dinamikës së strukturës së lëvizjes së bizneseve të veçanta. Sa i përket dinamikës së fillimit të ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme në territorin e Kosovës, në pjesën e parë të vitit 2011, numri i bizneseve të rexhistruara arrin në 2.166, dhe kjo tregon per 501 entitete ndërmarrëse të regjistruara më shumë në këtë pjesë kohore se sa në vitin e kaluar (ngritje

prej 23,1%). Sidoqoftë, në sferën e zvogëlimit të numrit të subjekteve të regjistruara, kemi zvogëlim prej 4,6%. E lartëpërmendura paraqitet në Figurën 3.5.




*Figura 3.5* – Numri i bizneseve të reja dhe të ri-regjistruara në territorin e Kosovës në periudhën 2004 – 2011 në baza tremujore (burimi: Q-2011)




*Figura 3.6* – Numri i përgjithshëm i ndërmarrjeve të reja dhe të ri-regjistruara në territorin e Kosovës në periudhën 2004 – 2001 (burimi: Q-2011)

Siq mund të vërehet nga Figura 3.5 dhe 3.6 pas vitit 2004, vërehet trendi i rënjes së numrit të ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme të regjistruara në territorin e Kosovës dhe që ky trend pas vitit 2007 insensifikohet (me një stagnim të vogël në vitin 2008 dhe 2009). Për të kuptuar më mirë dinamikën e sektorit të ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme dhe të ndërmarrësisë është e rëndësishme të tregohet edhe numri i ndërmarrjeve të mbyllura (Figura 3.7). Nëse krahasohet numri i ndërmarrjeve të filluara dhe të ri-regjistruara me numrin e ndërmarrjeve të mbyllura, mund të përfundojmë se bilanci është pozitiv, për shkak se numër më i madh i ndërmarrjeve fillojnë në krahasim me numrin e ndërmarrjeve që mbyllen. Situata konkrete për tremujorin e parë të vitit 2011 është 2.166 ndërmarrje të filluara në dallim prej 191 të mbyllura, që bën 8.82% të ndërmarrjeve të mbyllura (në 10 ndërmarrje të filluara dhe ri-regjistruara).




*Figura 3.7* – Numri i bizneseve të mbyllura në territorin e Kosovës në periudhën kohore prej 2005 deri 2011 i paraqitur në baza tremujore (burimi: Q-2011)

Segment tjeter shumë i rëndësishëm në analizimin e sektorit të ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme në territorin e Kosovës është struktura e subjekteve ekonomike të filluar e bazuar në madhësi dhe struktura e bazuar fushat e veprimit. Figura 3.8 tregon për strukturën e bazuar në madhësi.




*Figura 3.8* – Struktura e subjekteve ekonomike në bazë të madhësisë (burimi: Q-2011)

E rëndësishmë është edhe gjendja e strukturës së ndërmarrjeve në bazë të fushave të veprimit. Është e rëndësishme të tregohet për sektorët në të cilët ka ngritje të numrit të subjekteve ekonomike për shkak se kjo tregon edhe atraktivitetin (si dhe profitabilitetin) e vetë fushës së biznesit. Në bazë të këtij treguesi mund të parashihet numri i konkurrentevë të rinj.




*Figura 3.9* –Struktura e bizneseve të reja të rexhistruara në bazë të fushës së veprimit (Burimi: Q-2011)

Figura 3.9 tregom se në çfarë fushe janë të regjistruara subjektet ekonomike për kategori të caktuara. Siq mund të vërehet nga Figura, nga të gjitha kategoritë dominon kategoria e tregëtise me shumicë dhe pakicë. Përveç kësaj kategorie, fushat më atraktive për biznese të reja janë në fushën e hotelierisë, ndërtimtarisë dhe trasnportit, magacinimit dhe komunikimit. Këtu bëhet fjalë për fushat në të cilat shkalla e përfitimit është e lartë (sidomos në fazat fillestare). Faktori i dytë motivues për investime në fushat si tregëti, hotelieri është edhe periudha e shkurtë e kthimit të investimeve.

## 3.2 Analiza e sektorit të ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme dhe të ndërmarrësisë në territorin e Kllokotit

Segmenti i dytë i analizimit të sektorit të ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme dhe të ndërmarrësisë përfshin një pasqyrë të shkurtë të gjendjes në territorin e komunës së Kllokotit. Për shkak të qasjes së kufizuar në të dhëna relevante mbi gjendjen e NVM-ve në Kllokot, në këtë Draft do të përdorën informata të kombinuara të komunës së Vitisë ku kjo komunë bënte pjesë më heret, si dhe forma të ndryshme të aproksimitetit në mënyrë që të kemi informata për këtë sektor në kuadër të komunës së Kllokotit.

Numri i përgjithshëm i subjekteve ekonomike të sapo-regjistruara në tremujorin e parë të vitit 2011 është 2.166. Figura 3.10 tregon shtrirjen e këtyre bizneseve në bazë të lokacionit. Struktura e subjekteve ekonomike të sapo-themeluara në bazë të fushave të veprimit tregohet në Figuren 3.11.




*Figura 3.10* – Numri i subjekteve ekonomike të posa-themeluara në bazë të vendit ku janë rexhistruar (burimi: Q-2011)

Sa i përket komunës së Kllokotit, aktivitetet ekonomike janë në nivel të ulët të zhvillimit. Më herët kemi përmendur se komuna e Kllokotit ka përparësi konkurruese për shkak se gjendet në tokë të plleshme bujqësore, dhe Drafti do të fokusohet më shumë në këtë aspekt të aktiviteteve ekonomike. Prodhimi industrial është në nivel shumë të ulët. Në këtë pjesë kemi

vetëm industritë ekzistuese për ambalazhimin e ujit mineral si dhe punëtoria „AS Proces" që merret me prodhimin e mjeteve për procesim, drita ultraviolete për të kontrolluar kualitetin e ujit, makina paketimi etj. „AS Proces" momentalisht punëson 5 punëtorë të kualifikuar.

Përveq sektorëve të përmendur të bujqësisë dhe prodhimit industrial, në komunën e Kllokotit funksionojnë edhe disa ndërmarrje të rëndësishmë turistike që mund të jenë edhe bartësit kryesorë të ngritjes dhe zhvillimit ekonomik në 5 vjetorin e monitoruar. Në territorin e komunës së Kllokotit funksionojnë dy entitete ekonomike nga fusha e turizmit, këto janë „Nëna Naile" dhe „Banja e Kllokotit". Përveç kësaj, në Kllokot ekziston edhe një e ashtuquajtur mini-banjë që është rezultat i punës individuale të disa personave, që tregon potencialin e zhvillimit të turizmit në këtë fushë. Deri më tani potencialet turistike janë të pa-përdorura dhe kjo përfaqëson mundësi për zhvillim në të ardhmen.

Edhe një fushë tjetër që ka potencial dhe është prezente në territorin e komunës së Kllokotit është përpunimi i drurit dhe mobiljeve. Ky aktivitet ekonomik ka potencial të madh të zhvillimit për shkak të pranisë së burimeve natyrore (drunjëve) në rrethinën e Kllokotit. Ekzistojnë disa prodhues të vegjël të mobiljeve që në treg janë të dobët. Gjithashtu në komunën e Kllokotit ka kërkesë për ndërmarrje që merren me varrim (në vend të parë punimi i arkave) sepse këto shërbime mund ofrohen jasht territorit të komunës.




*Figura 3.11* – Struktura e ndërmarrjeve të sapo-themeluara në territorin e komunës së Vitisë për nga fushat e veprimit në tremujorin e parë të vitit 2011 (burimi: Q-2011)

Është më se e rëndësishmë të tregohët që nga fushat ekonomike, në këtë territor është në nivel të madh prezente fusha e tregtisë në formë të dyqaneve të vogla dhe marketeve të mëdha. Megjithatë, edhe pse këto subjekte ekonomike punësojnë numër të madh të punëtorëve, e ardhmja e komunës nuk duhet të bazohët në këtë fushë sepse kjo do të thotë mos-shfrytëzimin e burimeve ekzistuese natyrore dhe njerëzore dhe fuqizimin e orientimit afatshkurtë të zhvillimit ekonomik.

Dhjetë subjektet më të mëdha ekonomike në komunën e Kllokotit në bazë të kriterit të të punësuarëve janë: [1]

1. SH.P.K „Nena Naile" 200 punëtorë + punëtorë sezonal – i fushës së shërimit në banja
2. SH.P.K „Banja e Kllokotit" 150 punëtorë + punëtorë sezonal – i fushës së shërimit në banja
3. SH.P.K „Shensi" 50 punëtorë – bën prodhimin dhe ambalazhimin e ujit mineral
4. „Jeta" 20 punëtorë – bën prodhimin dhe ambalazhimin e ujit mineral
5. „Aqua Sana" 8 punëtorë – bën prodhimin dhe ambalazhimin e ujit mineral
6. N.T.P „ReraCom" 10 punëtorë - tregti
7. N.T.P„Thes Ari" - 8 punëtorë
8. „Radio Kllokot" – 6 punëtorë, program informativ
9. D.P.T „Beka" auto servis - 6 punëtorë
10. P.T.P „Maki" 5 punëtorë – tregti

## 4. Analiza „PEST"

Mënyrë shumë e dobishme për analizimin e kushteve të përgjithshme që ekzistojnë në kuadër të mjedisit të përgjithshëm është analiza „PEST". Kjo analizë përmban listë të pyetjeve për aspekte të rëndësishëm të mjedisit të përgjithshëm. Përbëhet nga katë kategori të pyetjeve: politike / aspekte ligjore, faktorë ekonomik, faktor shoqëroro-kulturor dhe faktorë teknologjik. Pjesët në vijim të Draftit kanë për qëllim identifikimin e faktorëve më të rëndësishëm nga kategoritë e lartëpërmendura që mund të kenë efekt pozitiv dhe / ose negativ në zhvillimin e sektorit të NVM-ve në territorin e komunës së Kllokotit.

### 4.1 Faktorët politik dhe ligjor

Një prej pyetjeve më të rëndësishmë në kuadër të faktorëve politik dhe ligjor është stabiliteti i këtyre faktorëve. Pjesë të rëndësishme për krijimin e klimës së mirë investuese tregojnë gjendjen e mjedisit ekonomik, stabilitetit politik dhe sistemit funksionues ligjor. Kjo është gjendja e faktorëve politik / juridik të cilët duhet të ndiqen gjatë implementimit të kësaj strategjie për zhvillimin e sektorit të NVM-ve dhe ndërmarrësisë.

Faktorët kryesorë nga sfera politike dhe juridike mund të kenë efekt pozitiv dhe / ose negativ në sektorin e ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme dhe të ndërmarrësisë, dhe në lidhje me zhvillimin e ardhshëm të komunës së Kllokotit janë:

- Stabiliteti politik në Kosovë
- Marrëveshjet politike dhe juridike me Bashkimin Evropian dhe vendet nga Ballkani
- Marrëdhënjet politike me vendet fqinje
- Ligjet që kanë të bëjnë me standarde të ndryshme për prodhim (në fushën e ushqimit në rend të parë)
- Ligjet për mbrojtjen e mjedisit

[1] Izvor: *Šta treba da sadrži profil zajednica u opštini Klokot*, radni nacrt, 1. april 2011. godine

- Ligjet kundër krijimit të monopolit si dhe ligjet për mbrojtje nga konkurrenca
- Politikat tatimore
- Ligjet e punës
- Puna e Agjencisë për ndërmarrje të vogla dhe të mesme
- Liberalizimi i marrëdhënjeve tregtare
- Stimulimet e mundshme për pjesëmarrje në tregjet ndërkombëtarë
- Marrëdhënja e qeverisë komunale me sektorin e NVM-ve
- Mundësia e subvencionimit të fushave prioritare të zhvillimit

### 4.2 Faktorët ekonomik

Kushtet e përgjithshme të zhvillimit dhe ndryshimeve, ndryshojnë në varësi prej faktit se a është zhvillimi në fazë të prosperitetit, recesionit, depresionit ose shërimit / rehabilitimit. Faktorë nga sfera ekonomike mund të gjenden në të dhënat për produktin e mbrendshëm bruto, kërkesa, prodhimi dhe konsumi. Gjendja e përgjithshme e një ekonomie të përgjithshme përcakton normën e papunësisë, inflacionit dhe fuqinë blerëse. Gjendja e një ekonomie të përgjithshme varet nga disponueshmëria e energjisë, për shkak se nevojat energjike nuk janë të kufizuara dhe për shkak se furnizimi me të nuk është i lirë. Në rastin e komunës së Kllokotit dhe sektorit të NVM-ve, faktorët kryesorë ekonomikë që do të paracaktojnë ngritjen dhe zhvillimin e këtij sektori janë:

- Cikli i zhvillimit në të cilin gjendet tregu
- Bruto prodhimi vendorë në Kosovë
- Normat e interesit për kreditë
- Ofrimi i kapitalit në treg, para së gjithash në fushën e kredive për start-up si dhe kredive për asete fikse
- Norma e inflacionit
- Fuqia blerëse e banorëve
- Disponueshmëria e energjisë
- Kostot e të bërit biznes
- Ndikimit të konkurrencës nga jashtë
- Cmimi për fuqinë punëtore në tregun vendor

### 4.3 Faktorët shoqëroro-kulturor

Ndikimi shoqërorë në subjektet ekonoikë nga sfera e NVM-ve dhe ndërmarrësisë buron nga qëndrimet, vlerat dhe zakonet që ekzistojnë në shoqëri. Faktorët nga kjo kategori zhvillohen më ngadale se komponentet tjera të mjedisit të jashtëm. Kjo për shkak se besimet primare, sistemi i vlerësimit, kultura dhe mënyra e jetesës përcaktojnë kategori relativisht të pandrysheshme. Elementi kryesor në analizë është demografia e banorëve dhe fuqia e tyre blerëse. Në analizë duhet kushtuar vëmendje në ndryshimet e mënyrës së jetesës, sistemit

të edukimit, marrëdhënjes së punës, shfrytëzimit të kohës së lirë dhe zhvillimit të vetëdijës për të drejtat e konsumatorëve.[2]

Elementet shoqëroro-kulturore të rëndësishëm për kategorine e NVM-ve dhe ndërmarrësisë janë:

- Struktura demografike e banorëve (që tregohet në tekstin e kësaj Draft strategjie)
- Shpërndarja e të ardhurave familjare
- Migrimi i popullsisë
- Ndryshimet në mënyrë e jetesës (
- Ndryshimet në përdorimin e kohës së lirë
- Zakonet e blerjes dhe konsumimit
- Niveli i edukimit të popullsisë
- Zakonet e besimit të popullsisë
- Mirëkuptimi dhe toleranca ndër-fetare
- Armiqësia potenciale për prodhimet e grupeve të ndryshme etnike

### 4.4 Faktorët teknologjik

Aspekti i teknologjisë varet nga përcjellja dhe vlerësimi i trendeve teknologjikë që kanë ndikim në sektorin e NVM-ve dhe ndërmarrësisë në komunën e Kllokotit. Përcjellja e trendeve teknologjike do të thotë mirëmbajtja e përparësisë konkurruese të një ekonomie kombëtare. Teknologjia ka ndikim në të gjitha sferat e jetës dhe për atë arsyje analizimi i këtyre faktorëve është më se i rëndësishëm dhe në pajtim me analizën e përgjithshme në komunën e Kllokotit. Më herët është përmendur se kjo komunë momentalisht disponon me infrastrukturë të kënaqshme në sferën teknologjike (telekomunikim, furnizim me energji elektrike, pajisje teknike). Duke qenë se investimet në këtë fushë janë të karakterit të vazhdueshëm, është e rëndësishmë të kemi parasysh faktorët të natyrës teknologjike që mund të kenë ndikim pozitiv/negativ në sektorin e ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme dhe të ndërmarrësisë:

- Hyrja në sektorin e hulumtimit dhe zhvillimit
- Infrastruktura e telekomunikacionit
- Karakteristika e hardëare dhe softëare
- Shkalla e vjetërsisë e teknologjive ekzistuese të prodhimit
- Shpejtësia e vjetërsimit të teknologjisë në fusha të caktuara ekonomike
- Shkalla e njohjes dhe edukimit të banorëve me trende dhe me mundësi që ofrohën nga teknologjitë e reja
- Varësia e fushave ekonomike me trendet në fushën e teknologjisë
- Niveli i hyrjes në teknologji të reja nga ana e strukturave ekzistuese të NVM-ve dhe ndërmarrësisë

[2]Ibidem, str. 323

- Orientimi drejt inovacioneve dhe njohjeve të reja
- Menaxhimi i njohjes dhe hyrja në njohuri të reja teknologjike
- Përkrahja e zhvillimit të bizneseve inovative dhe rritja e zhvillimit të parqeve teknologjike

## 5. Analiza SWOT për sektorë të ndryshëm ekonomik

Rezultatet e analizës së mjedisit të jashtëm duhet të ndërlidhën me mundësi të mbrendshme. Qëllimi i analizimit të potencialeve të komunës është që të vërtetohet se çfarë mund të bëjë komuna e cila është duke u analizuar, duke pasë parasysh anët e forta dhe të dobëta në mjedisin e jashtëm në të cilin ekziston. Analiza e fuqive dhe dobësive tregon që burimet e komunës nuk varen vetëm nga kushtet e tanishme, por edhe nga kushtet që do të paraqiten në të ardhmën. Për më shumë, fuqite e tanishme mund të jenë të parëndësishmë për të ardhmën, por edhe dobësitë dhe mangësitë e tanishme mund të shëndrohen në fuqi në të ardhmën. Si pasojë analiza e fuqive dhe dobësive nuk duhet të kufizohet vetëm me pozitën e tanishmë por duhet të tregojë edhe se çfarë mund të bëjë komuna, me mundësitë, potencialet dhe rreziqet e jashtme.

Drafti strategjia për zhvillim të ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme dhe të ndërmarrësisë në komunën e Kllokotit do të fokusohet në implementimin e analizës SWOT për sektorë të ndryshëm ekonomik, që janë identifikuar si primar dhe me rëndësi strategjike për zhvillimin e kësaj komune. Sektorët ekonomik në të cilët duhet të investohet në mënyrë intenzive dhe që duhet të zhvillohen në periudhë afatgjatë janë:

1. Prodhimet bujqësore
2. Prodhimi dhe ambalazhimi i ujit mineral
3. Zhvillimi i turizmit në banja
4. Përpunimi i drurit

Në pjesët në vijm të Draft strategjisë do të analizohet secili sektor ekonomik dhe do të zhvillohet analiza SWOT për secilin sektor.

### 5.1 Prodhimet bujqësore

Prodhimet bujqësore në territorin e Kllokotit sot nënkupton prodhimin e patateve, specave, lakërave, grurit, misrit, pjepërit, shalqinit. Hapat e mundshëm zhvillimor të këtij sektori, para së gjithash për shkak të kushteve të mira klimatike dhe për shkak të plleshmërisë së tokës janë prodhimi i frutave, zhvillimi i blegtorisë, rritja e kërmillave, rritja e karrotave. Mesatarisht rreth 97% e banorëve merren me ndonjë formë të prodhimit bujqësorë me qëllim të shfrytëzimit personal (rreth 70% të prodhimit të përgjithshëm, sipas statistikave të dhëna nga prodhuesit lokal bujqësorë). Prodhimet bujqësore nuk tatohen për shkak se prodhuesit nuk bashkëpunojnë me blerës në sasi të madhe (të sektorit të shitjes me shumicë dhe pakicë) dhe nuk kanë interes financiar t'a bëjnë këtë. Dyqane me produkte bujqësore thuja se nuk ka, ekziston vetëm një dyqan me produkte bujqësore në fshatin Mogila. Kjo tregon mundësi potenciale për të ardhmën për të ngritur ndikimin dhe efikasitetin e këtij sektori. Problemi më i madh në sektorin e bujqësisë në komunën e Kllokotit është mungesa

e çertifikimit adekuat për produket e finalizuara bujqësore, mos-përmbushja e standardeve të kualitetit, mekanizimi i vjetërsuar, mungesa e kapitalit punues, rënja e vazhdueshme e fondit të bagëtisë dhe tregu i kufizuar i shitjes (në aspektin e madhësisë së tregut dhe refuzimit të mundshëm nga grupe të ndryshme etnike).

Poljoprivrednih udruženja (zadruga) gotovo i da nema. Postoji samo jedna poljoprivredna zadruga u selu Mogila. Ovo predstavlja potencijalnu šansu u budućnosti koja može doprineti podizanju efektivnosti i efikasnosti ovog sektora. Najveći problemi sektora poljoprivrede u opštini Klokot su nedostatak adekvatne sertifikacije gotovih proizvoda, neispunjavanje standarda kvaliteta, zastarela mehanizacija, nedostatak obrtnih sredstava, konstantno smanjenje stočnog fonda i ograničeno tržište prodaje (u smislu veličine i potencijalnog neprihvatanja od strane različitih etničkih grupa). Analiza SWOT për prodhimet bujqësore është e paraqitur më poshtë në Figurën 5.1.

| FUQITË | DOBËSITË / MANGËSITË |
|---|---|
| • Kualiteti i tokës<br>• Pozita gjeografike e komunës<br>• Kualiteti i produktit final bujqësorë<br>• Klima e favorshme<br>• Karakteristikat e fuqisë ekzistuese punëtorë (përvoja në prodhimtari bujqësore, tradita e lashtë)<br>• Profesionalizmi në bashkëpunimin biznesor<br>• Njohuri të akumuluar në lidhje me punimin e tokës<br>• Kapacitetet ekzistuese për prodhim bujqësorë (sera, frigorifer për ruajtjen e produkteve të finalizuara, depo)<br>• Harxhimet e ulëta për prodhim<br>• Harxhimet e ulëta për burimet njerëzore<br>• Konkurrent në treg me çmim<br>• Numër i madh i prodhuesëve të vegjël (fleksibiliteti)<br>• Ekzistenca e dyqanit (në territorin e fshatit Mogila) | • Mekanizmi / teknologjia e vjetërsuar<br>• Numër i vogël i prodhuesëve bujqësorë që posedojnë teknologji / mjete mekanike<br>• Sistemi i ujitjes së tokës<br>• Numër i vogël i ftofësve / frigoriferëve që do të plotësonte nevojat e vëllimit në rritje të produkteve bujqësore<br>• Mungesa e njohurisë në sferën e shitjes së produkteve të finalizuara<br>• Format e pandërtuara të distribuimit<br>• Mungesa e çertifikatave për plasman të gjerë të produkteve të finalizuara<br>• Mungesa e informimit për prodhuesit bujqësorë<br>• Mungesa e mjeteve financiare për investime<br>• Mungesa e çertifikatave të posaçme për të dëshmuar për kualitetin e tokave bujqësore<br>• Mungesa e orientimit në treg e prodhuesëve<br>• Sasia e kufizuar e prodhimeve bujqësore<br>• Mungesa e njohurive konkrete nga fusha e menaxhimit dhe marketingut<br>• Mos-njohja e metodave moderne të prodhimit |
| **MUNDËSITË** | **KËRCËNIMET** |
| • Hyrja e prodhimit sekondar (fillimi i fabrikës për prodhimin e qipsave që do të ndihmonte në eksploatimin e kapaciteteve ekzistuese për prodhimin e patateve) | • Mungesa e stabilitetit politik në nivel të qeverisë së Kosovës dhe në nivel të qeverisë komunale<br>• Fuqizimi i liberalizimit të tregut të importimit të produkteve bujqësore |

| | |
|---|---|
| • Partneritetet me investitor dhe donatorë potencial<br>• Shtimi i angazhimit të organeve komunale në fushën e krijimit të kushteve buxhetore për subvencionimin e prodhimeve bujqësore<br>• Komunë e re që ka burime kualitative dhe paraqet mundësi atraktive për investime<br>• Shkrimi i projekt propozimeve të reja për përmirësimin e prodhimit bujqësorë<br>• Paraqitja e kredive me kushte më të mira për bujqësi<br>• Ardhja më e shpeshtë hipermarketeve<br>• Hapja e tregjeve të reja gjeografike në dhe jashtë territorit të Kosovës<br>• Mbrojtja e prodhimeve bujqësore përmes prezantimit të formave të ndryshme të mbrojtjes si doganat, tatimet, kuotat<br>• Subvencione për importimin e makinerisë moderne bujqësore<br>• Krijimi i shoqatave të reja të prodhuesëve bujqësorë në formë të klasterëve me qëllim të ofrimit të qasjes së njejt për blerësit dhe për aplikim për projekte të ndryshme<br>• Organizimi i tregut në territorin e komunës së Kllokotit<br>• Edukimi në fushat moderne të prodhimit bujqësorë | • Ndikimet nga ndryshimet klimatike dhe fatkeqësive të ndryshme natyrore në dëm të prodhimit bujqësorë<br>• Politika tatimore më strikte që do të rezultojë në vënien e angazhimeve financiare shtesë për fermerët dhe kështu të reduktojë konkurrencën e produkteve finale në tregNestabilnost političke situacije na nivou vlade Kosova i na nivou opštinske vlasti<br>• Inflacioni<br>• Hyrja e kompanive të mëdha në sferën e prodhimit bujqësor<br>• Mos-pranimi i produkteve finale nga grupet e tjera etnike në Kosovë<br>• Marrëveshjet e mbrendshme e blerësve të mëdhenj që përfaqësojnë tregun e synuar të prodhuesëve të komunës së Kllokotit |

## 5.2 Prodhimi dhe ambalazhimi i ujit mineral

Si prioritet i dytë strategjik i identifikuar është prodhimi dhe ambalazhimi i ujit mineral. Është thënë që komuna e Kllokotit është ë pasur me burime termo-minerale. Këto burime janë të vendosura në thellësira të vogla të tokës, që i bën këto burime dhe këtë fushë ekonomike jashtëzakonisht fitimprurëse dhe të veçantë. Është e rëndësishme të theksohet që në këtë fushë ekziston bashkëpunimi ndërmjet njërës fabrikë të ujit dhe një banje lokale të shërimit.

Dy produkte themelore në të cilat duhet të fokusohemi është uji mineral dhe $CO_2$. Të dy produktet kanë potencial të madh për përpunim të mëtejshëm dhe për përfshierje në kategori të ndryshme më të larta të përpunimit. Potenciali më i madh i identifikuar në këtë fushë ekonomike është prodhimi i lëngjeve të gazuara. Problemi më i madh në fushën e përpunimit të ujit mineral është mungesa e kushteve financiare për investim në teknologji të reja. Figura 5.2. paraqet analizën „SWOT" të sektorit të prodhimit dhe ambalazhimit të ujit mineral dhe $CO_2$.

| FUQITË | DOBËSITË / MANGËSITË |
|---|---|
| • Pasuritë natyrore të ujit mineral<br>• Kualitet i lartë kimik dhe biologjik i ujit<br>• Kapaciteti ekzistues kualitativ për ambalazhimin e ujit<br>• Tradita shumë-vjecare në këtë fushë të prodhimit<br>• Posedimi i të gjitha certifikatave të nevojshme për qasje në shitje me shumicë dhe pakicë<br>• Posedimi i makinerisë kualitative për ambalazhim<br>• Anët mjekësorë të ujit termo-mineral dhe lidhja pozitive e njerëzve në lidhje me këtë<br>• Burimet njerëzore kualitative të punësuar në kuadër të kapaciteteve ekzistuese për përpunim dhe ambalazhim<br>• Kontrollë e rregullt e kualitetit të ujit që direkt kontribuon në kualitetin final të produktit<br>• Prodhimi i $CO_2$ | • Edhe pse në nivelin e kënaqshëm cilësia e infrastrukturës (rrugët dhe furnizimi me energji elektrike) nuk është në nivel të mjaftueshëm për nevojat e industrisë<br>• Aktivitetet jo-adekuate të marketingut në këtë sektor<br>• Rrjeti i keq i distribucionit<br>• Mungesa e kapitalit të punës për prodhim, kryesisht të të hollave<br>• Kostot e larta të mirëmbajtjes së makinerisë ekzistuese për prodhim dhe paketim<br>• Kostoja e lartë e lëndëve të para<br>• Produkti jo-konkurrent në tregun ndërkombëtarë për shkak të kostove të larta të të bërit biznes (para së gjithash kostove të mirëmbajtjes së makinerisë) |
| **MUNDËSITË** | **KËRCËNIMET** |
| • Ardhja e investitorëve dhe donatorëve potencial<br>• Intensifikimi i bashkëpunimit me sektorin jo-qeveritar<br>• Zhvillimi i turizmit që do të ndikonte në zhvillimin e këtij sektori ekonomik, para së gjithash duke intensifikuar bashkëpunimin me banjat ekzistuese të shërimit dhe përmes shitjes direkte turistëve<br>• Investime shtesë në përmirësimin e infrastrukturës<br>• Bashkëpunimi potencial me kompani të mëdha nga fusha e prodhimit të pijeve të pa-gazuara dhe pijeve të gazuara<br>• Shfaqja e furnizuesit për shërbime të punimit të materialeve promovuese dhe | • Ndikimi i politikës në këtë sektor ekonomik<br>• Futja e akcizës në ujë<br>• Situata jo-stabile politike në Kosovë dhe në territorin e komunës<br>• Rënja e fuqisë blerësve të banorëve<br>• Hyrja e prodhuesëve të rinj të produkteve të njejta<br>• Ngritja e inflacionit në periudhën e planifikuar kohore<br>• Marrëveshjet e mbrendshme të blerësve të mëdhenj<br>• Ngritja e vazhdueshme e taksave nga organet komunale<br>• Zvogëlimi i sasisë së ujit për shkak të intensifikimit të shpimit të pa-planifikuar në territorin e komunës |

| | |
|---|---|
| disejnimi i qasjes marketuese të prodhuesëve të këtij territori<br>• Pjesëmarrja në panaire jasht territorit të Kosovës me qëllim të krijimit të kontakteve të reja biznesore<br>• Stabilizimi i më-tutjeshëm i situatës politike dhe ngritja e stabilitetit ekonomik<br>• Liberalizimi i tregëtimit me jashtë dhe qasja në tregje të reja<br>• Promovimi i eksportit nga agjenci të ndryshme dhe nga udhëheqësia lokale | |

*Figura 5.2* – Analiza SWOT e sektorit të prodhimit të ujit të ambalazhuar dhe $CO_2$ në komunën e Kllokotit

### 5.3 Zhvillimi i turizmit në banja

Për shkak të pasurive natyrore me ujë termo-mineral, komuna e Kllokotit në vete ka përparësi të madhe konkurruese. Komuna e Kllokotit është e pasur me burime termo-minerale me temperaturë mesatare prej 38°C. Ky ujë ka ndikim të dobishëm për të sëmurit nga reuma, ishiasi, sëmundje të sistemit nervor, sëmundje të lëkurës, sëmundje të barkut, sëmundje kardiovaskulare, gjendje post-traumatike, dhe për këtë arsyje është fushë primare në të cilën duhet investuar. Në territorin e komunës së Kllokotit momentalisht funksionojnë tri banja shëruese dhe dy prej tyre më se të famshme janë „Nëna Naile" dhe „Banja e Kllokotit". Përveq të lartëpërmendurave, ekziston edhe një banjë e vogël me kapacitete bazike. Përveq kësaj, fusha që ka potencial në territorin e komunës së Kllokotit është edhe turizmi në ferma apo turizmi në fshat.

Problemet që janë identifikuar nga përfaqësuesit e këtij sektori janë investimet e vogla në anën e telekomunikimit si dhe investimet për zhvillim afat-gjatë të këtij sektori ekonomik. Përparësia e këtyre banjave është që me cmime shumë të ulëta mund të sigurohen materialet e nevojshme për ushqimin e mysafirëve. Njëra prej banjave ka identifikuar këtë mundësi dhe ka hapur fermën e produkteve bujqësore për të përmbushur nevojat e banjës. Në Figurën 5.3 tregohen elementet e analizës SWOT në kontekstin e zhvillimit të ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme nga fusha e turizmit në banja.

| FUQITË | DOBËSITË / MANGËSITË |
|---|---|
| • Pasuria natyrore (burime termo-minerale me temperaturë 38°C)<br>• Pozita e mirë gjeografike (largësia nga Prishtinë prej 50 km) dhe lidhja e mirë me qendrat e tjera të rëndësishme (Beograd-Nish-Selanik-Athinë)<br>• Banjat shëruese kualitative prezente<br>• Fabrika e prodhimit të ujit mineral | • Mos-përfillja e aktiviteteve të marketingut tregojnë që banja nuk është mjaftueshëm e ditur për klientët potencial<br>• Strukturë e pa-arsimuar e banorëve në komunën e Kllokotit – numër i pamjaftueshëm i ekspertëve në fushën e hotelierisë dhe mjekësisë (momentalisht të punësuar janë banorë të komunave |

| | |
|---|---|
| ekzistuese<br>• Mikëpritje tradicionale<br>• Kushtet e mira klimatike<br>• Afërsia me bukuri tjera natyrore dhe me pika turistike<br>• Banja e vetme në territorin e Kosovës<br>• Cmime shumë të përballueshme<br>• Kapacitete të mjaftueshme për strehim<br>• Ekzistimi i kompleksit modern për IVF trajtim | tjera)<br>• Zhvillim i pa-planifikuar i turizmit në territorin e komunës<br>• Orientimi i pamjaftueshëm në ndërmarrje shërbyese në përgjithësi<br>• Mungesa e qendrës së informacionit për turistë |
| **MUNDËSITË** | **KËRCËNIMET** |
| • Më shumë investime në hulumtimin e burimeve ujore në territorin e komunës<br>• Investime në përmirësimin e infrastrukturës ekzistuese<br>• Zhvillimi i mundësive tjera turistike (turizmi në ferma)<br>• Inicimi i sektorit të shërbimeve tjera (suveniret, programe të guidimit turistik, ekskurzione)<br>• Ndërtimi i kompleksit rekreativ – sportiv<br>• Organizimi i seminareve, trajnimeve dhe panaireve të ndryshme<br>• Promovimi i kremtimit të ditës së Shën Pjetrit si festë tradicionale dhe festimi me aktivitete të ndryshme argëtuese<br>• Insistimi për lidhjet ndër-komunale<br>• Investimi në arsimimin e kuadrit të nevojshëm<br>• Zhvillimi i qendrës informative turistike<br>• Krijimi i ofertës turistike gjithë-përfshirëse<br>• Organizimi i aktiviteteve tjera argëtuese, të nevojshme dhe interesante<br>• Bashkëpunimi me sektorin jo-qeveritar (marrja e informatave të dobishme, pjesëmarrja në trajnime të ndryshme) | • Paragjykimet negative të klientëve për nivelin e sigurisë në territorin e komunës dhe në Kosovë në përgjithësi<br>• Situata jo-stabile politike, si në nivel të Kosovës ashtu edhe në nivel të komunës<br>• Problem me furnizimin me energji elektrike (ka ndërprerje të kohëpaskohshme të energjisë elektrike)<br>• Ndërprerja e zakoneve dhe zanateve tradicionale për shkak të mungesës së përfitimit nga të njejtit<br>• Ndërprerja e manifestimeve tradicionale për shkak të mungesës së përkrahjes<br>• Komunikimi i dobët<br>• Trendi i eksodit të të rinjëve në qendra më të mëdha<br>• |

*Figura 5.3* – Analiza SWOT e ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme dhe e ndërmarrësisë në fushën e turizmit në banja në komunën e Kllokotit

### 5.4 Përpunimi i drurit

Prioriteti i fundit strategjik në komunën e Kllokotit është përpunimi i drurit, në vend të parë prodhimi i mobiljeve si dhe përpunimi i mobiljeve të vjetra. Kategoritë më të rëndësishme të prodhimit në të cilat sot varet mbijetesa e njeriut që merren me këto punë janë prodhimi dhe përpunimi i shtretërve, punimi i elementeve të kuzhinës (të gjitha llojet dhe

dimensionet), zhvillimin e koshereve (gjatë sezonës shfaqet kërkesë e jashtzakonshme për këtë lloj prodhimi nga druri). Deri tani, në territorin e komunës së Kllokotit ekziston vetëm një prodhues i madh i mobiljeve, dhe pasta 4 prodhues të vegjës që janë zyrtarisht të rexhistruar dhe një numër i madh i prodhuesëve që veprojnë në sferën e ekonomisë jo-formale. Duhet të kushtohet vëmendje e vecantë në të ardhmën në prodhimin e pjesëve të ndryshme për organizimin e funeraleve (që prodhohen nga druri) për shkak se në territorin e komunës nuk ekziston asnjë subjekt privat ekonomik që merret me këtë lloj të punës. Të gjitha këto pajisje importohen nga Serbia.

Pengesat kryesore për zhvillim të mëtutjeshëm të këtij sekroti janë mungesa e burimeve financiare, makineria e vjetërsuar për prodhim, mungesa e njohurisë në fushën e menaxhimit të biznesit dhe marketingut. Në Figurën 5.4. mund të gjeni analizën „SWOT" për sektorin e përpunimit të drurit.

| FUQITË | DOBËSITË / MANGËSITË |
|---|---|
| • Cilësia e burimeve nga të cilët bëhet prodhimi i produktit final dhe që fitohet nga burimet vetanake dhe nga importi<br>• Ekzistimi i përvojës shumëvjecare në këtë fushë ekonomike<br>• Traditë shumëvjecare në përpunimin e drurit dhe prodhimin e mobiljeve nga druri<br>• Prodhim konkurrues në aspektin e cilësisë dhe cmimit<br>• Cilësi e dëshmuar e produktit final si rezultat i burimeve cilësore, i përvojës dhe traditës shumëvjecare<br>• Fleksibilitet i treguar i prodhuesëve të vegjël në aspektin e bisedimit për cmim, për njësitë dhe për datat e prodhimit<br>• | • Mungesa e kapitalit të punës<br>• Teknologjia e vjetër për përpunimin e drurit dhe për prodhimin e mobiljeve<br>• Mungesa e kreativitetit të prodhuesëve në sensin që prodhohen vetëm pjesë tradicionale të mobiljeve<br>• Mungesa e aktiviteteve promovuese<br>• Orientimi vetëm në popullatën lokale dhe mungesa e ambicieve për të dalur nga vendi<br>• Mungesa e burimeve njerëzore cilësore |
| **MUNDËSITË** | **KËRCËNIMET** |
| • Hapja e kufijve dhe liberalizimi i tregut qe mund të rezultojë në rritjen e kërkesës në tregjet jashtë Kosovës<br>• Pyllëzimi i pjesëve të caktuara që të sigurohen lëndët e para<br>• Bashkëpunimi me prodhuesit bujqësorë<br>• Paraqitja e investitorëve të interesuar në sukses afatgjatë<br>• Përfundimi i ofertës ekzistuese dhe futja e prodhimeve të reja, suvenirëve<br>• Ngritja e fuqisë blerësve të banorëve të | • Paraqitja e konkurrences ndërkombëtare<br>• Pasiguria në furnizimin me energji elektrike që direkt dëmton procesin e prodhimit<br>• Paraqitja dhe ngritja e taksave dhe tatimeve të ndryshme<br>• Depyllëzimi i pa-planifikuar<br>• Ngritja e vazhdueshme e cmimit për lëndën e parë<br>• Luhatjet në cmimin e drurit<br>• Inflacioni |

| | |
|---|---|
| Kosovës<br>• Hapja e dyqanit për shitjen e pjesëve të funeraleve në territorin e komunës së Kllokotit<br>• Ngritja dhe pjesëmarrje në panairet e kësaj fushe<br>• Pjesëmarrja në trajnime të ndryshme (shkrimi i biznis planeve, shkrimi i projekteve)<br>• Pjesëmarrje në konkurse dhe gara për ndarje të ndryshme të granteve | |

*Figura 5.4* –Analiza „SWOT" e ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme dhe e ndërmarrësisë, në fushën e përpunimit të drurit në territorin e komunës së Kllokotit

Qëllimi i punimit të analizës „SWOT" për secilën fushë të zhvillimit që janë të paracaktuara si prioritete strategjike për zhvillim në komunën e Kllokotit, është për të parë faktoret e mbrendshëm dhe të jashtëm të mjedisit, njoftimi më i mirë i tyre dhe me qëllim të përdorimit të fuqive, të minimizimit të mangësive, të kapitalizimit të mundësive dhe të largimit nga kërcënimet. Rezultati i kësaj analize duhet të reflektojë në shtimin e gatishmërisë të organeve komunale në implementimin e strategjisë për zhvillimin e ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme dhe të ndërmarrësisë.

## 6. Vizioni dhe misioni i komunës në fushën e NVM-ve dhe të ndërmarrësisë

Pjesa në vijim e Draftit identifikon dy lëvizës / katalizatorë të performancës në të ardhmen, dhe këta janë: vizioni dhe misioni i komunës së Kllokotit. Vizioni zakonisht përcakton drejtimin e lëvizjes në afat të gjatë dhe ka për qëllim kryesorë që në mënyrë të qartë, të vecantë, të arritshme dhe logjike të motivojë të gjithë akteret nga fusha ekonomike dhe politike të përmbushin qëllimet që duhet të dalin prej saj. Vizioni i komunës së Kllokotit është rezultat i përbashkët i përfaqësuesëve të organeve komunale dhe njerëzve të punësuar lokal për të përcaktuar angazhimin e tyre afat-gjatë në fushën e zhvillimit të sektorit të NVM-ve në komunë. Duke rrespektuar të gjitha propozimet e pjesëmarrësve në punëtorinë për punimin e Draft strategjisë, vizioni i komunës së Kllokotit në fushën e zhvillimit të ndërmarrjeve të të vogla dhe të mesme dhe të ndërmarrësisë duket kështu:

***Qëndrojmë dhe jemi duke u përpjekuar për t'u transformuar në një vend modern, të fortë, atraktiv dhe të sukseshëm, duke ofruar mbështetje të lartë për rritjen e shëndoshë të ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme dhe të ndërmarrësisë.***

***Suksesi në të ardhmën do të jetë pasojë e prodhimit bujqësorë modern, turizëm i famshëm në banja, ujë i shëndetshëm dhe mobilje të kualitetit dhe të disejnit të lartë***

Pjesa në vijim e planit strategjik përbëhet nga misioni i komunës së Kllokotit. Misioni ka për qëllim të ofrojë një mendim të qartë dhe të thjeshtë të asaj se cfarë komuna ofron për banorët e ardhshëm, për klientë, investitorë, donatorë dhe për të gjithë stejkholldierët e tanishëm dhe të ardshëm.

Duke falenderuar kontributin cilësorë të pjesëmarrësve në punëtori për këtë temë, misioni i komunës së Kllokotit duket si në vijim:

***Komuna e Kllokotit është vend i shëndetshëm, natyral, cilësorë dhe i këndshëm për të bërë biznes.***

## 7. Qëllimet strategjike të zhvillimit të NVM-ve

Qëllimet strategjike janë vendime për plane që dalin nga definimet e mëhershme të vizionit dhe misionit dhe tregojne drejtime konkrete për të ardhmën. Që të jenë qëllimet e dobishme dhe të implementueshme duhet të përmbajnë karakteristikat në vijim:

- Të jenë specifik dhe të qartë
- Të jenë të matshëm
- Të jenë të arritshëm
- Të jenë optimist realisht dhe
- Të kenë kohë dhe afat të definuar.

Duke pasë parasysh që në rastin konkret bëhet fjalë për formulimin e planeve strategjike për qëllime të zhvillimit të ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme dhe të ndërmarrësisë së komunës, qëllimet që do të paraqiten do t'i referohen periudhës së hulumtuar 5 vjecare.

Rezultatet konkrete që janë në pajtim me vizionin dhe misionin e komunës janë të definuar si në vijim:

Qëllimi strategjik 1:
**FUQIZIMI I RRITJES SË SHËNDOSHË TË SEKTORIT TË NVMN ME QËLLIM TË NGRITJES SË NUMRIT**

Qëllimi strategjik 2:
**FUQIZIMI I NIVELIT TË EKSPERTIZËS SË NDËRMARRËSVE, PRONARËVE DHE MENAXHERËVE TË NDËRMARRJEVE TË VOGLA DHE TË MESME**

Qëllimi strategjik 3:
**NGRITJA E INVESTIMEVE NË FUSHËN E PRODHIMEVE BUJQËSORE ME QËLLIM TË MODERNIZIMIT TË NJEJTËS**

Qëllimi strategjik 4:
**INVESTIMIN NË ZHVILLIMIN DHE MODERNIZIMIN E SEKTORIT TË TURIZMIT**

Qëllimi strategjik 5:

**PROMOVIMI INTENZIV I BURIMEVE UJORE SI PËRPARËSI TË RËNDËSISHME KONKURRUESE TË TERRITORIT**

Qëllimi strategjik 6:
**FUQIZIMI I ZHVILLIMIT TË SEKTORIT TË KONZERVIMIT DHE PËRPUNIMIT TË UJIT**

Qëllimi strategjik 7:

**FUQIZIMI I RRITJES DHE ZHVILLIMIT TË SHËNDOSHË TË NDËRMARRJEVE TË VOGLA DHE TË MESME**

Qëllimi strategjik 8:
**INVESTIMI NË MIRËMBAJTJEN E INFRASTRUKTURËS EGZISTUESE DHE NË NDËRTIMIN E ELEMENTEVE TË REJA TË INFRASTRUKTURËS**

Qëllimi strategjik 9:
**INVESTIMI NË ARSIMIM TË KUADROVE PROFESIONALE NË PAJTIM ME NEVOJAT QË DALIN NGA ZHVILLIMI I SEKTORËVE TË PRIORITIZUAR EKONOMIK**

## 8. Vërrejtjet përmbyllëse

Draft strategjia për zhvillim të ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme dhe të ndërmarrësisë të komunës së Kllokotit përbëhet nga disa elemente të rëndësishmë. Fillimisht, kjo është analiza shoqëroro-ekonomike e komunës me pasuri natyrore, karakteristika demografike të komunës (të moshës, gjinisë, struktura me bazë të përkatësisë etnike), ekzistimin e infrastrukturës (furnizimin me ujë të pijshëm, energji elektrike, telekomunikimin, inrastrukturë rrugore etj) si dhe elemente të zhvillimit lokal ekonomik të komunës.

Pjesa e dytë e Draftit është marrë me analizimin e gjendjes në sektorin e ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme dhe të ndërmarrësisë, si në territorin e gjithë Kosovës, ashtu edhe në territorin e komunës së Kllokotit. Kjo analizë ka ofruar të dhëna të dobishme për trendet në fushën e themelimit të subjekteve të reja ekonomike në afat më të gjatë kohor. Gjithashtu, është vërjetur trendi i rrjitjes së themelimit të subjekteve të reja ekonomike në periudhën 2007 – 2011 që është tregues i mirë i rritjes së ekonomisë. Kjo mund të vërtetohet me faktin se shumicën absolute të bizneseve ekzistuese e formojnë NVM-të. Ky trend vazhdohet edhe në komunën e Kllokotit dhe tregon që qeveria e Kosovës dhe qeveria lokale e komunës së Kllokotit janë në pajtim me orientimin e përbashkët në sektorin e biznesit të vogël. Gjithashtu, principet e sektorit të NVM-ve janë në pajtim me Konventën e ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme të Bashkimit Evropian.

Pjesa në vazhdim e këtij dokumenti merret me analizimin e mjedisit të përgjithshëm ku funksionojnë ndërmarrjet e vogla dhe të mesme dhe ndërmarrësit. Në lidhje me këtë është bërë PEST analiza e cila ka ofruar pasqyrën e faktorëve politik / ligjor, ekonomik, shoqërorokulturor dhe nga sfera e teknologjisë në territorin e Kosovës dhe komunës së Kllokotit.

Pjesë shumë e rëndësishme e këtij Drafti është SWOT analiza për sektorët më të rëndësishëm ekonomik në komunën e Kllokotit. Si rezultat i bashkëpunimit me përfaqësues

lokal të ekonomisë dhe udhëheqësisë komunale, janë bërë SWOT analizat e detajizuara të prodhimit të bujqësisë, përpunimi dhe ambalazhimi i ujit mineral, turizmit në banja dhe përpunimit të drurit. Këta katër sektorë të prodhimit ekonomik janë të ndara si prioritete strategjike të zhvillimit të sektorit të NVM-ve në Kllokot.

Pjesa në vijim e Draftit përfshin definimin e vizionit, si parashikim afatgjatë dhe optimist në rritjen dhe zhvillimin e komunës së Kllokotit. Pas kësaj është i identifikuar misioni i komunës. Nga vizioni dhe misioni kanë dalë qëllime të rëndësishme strategjike, si vendime të bërjes së planeve për periudhën pesë vjeçare me qëllim të përmbushjes së vizionit.

Në bazë të analizës strategjike, që përmban të gjitha ato që janë bërë dhe shkruar deri më tani, udhëheqësia komunale duhet të ndajë qëllimet operative, projekte kritike dhe aktivitete konkrete me qëllim të realizimit të vizionit dhe qëllimeve strategjike. Është i rëndësishëm rrespektimi i mendimit të ndërmarrësve lokal në fushën e definimit të prioriteteve strategjike me qëllim të koordinimit dhe të ndëgjimit të mendimit të atyre që kontribuojnë sot dhe për të ardhmën.

## 9. Pjesëmarrësit në punëtori

1. Rexhep Lani (bujk)
2. Nebojsa Vujic
3. Stefan Nikolic (student)
4. Stanimi Mitrovic (punëtorë)
5. Doran Denic (ndërmarrja „Aqua Koki")
6. Milos Denic (zyrtarë)
7. Sami Maksuti (Banja e Kllokotit)
8. Reshat Lika (ndërmarrja Jeta)
9. Nikola Stolic (Radio Kllokot)
10. Besim Arifi (përfaqësues fshati)
11. Sinisa Moskic (bujk)
12. Bojan Krcmareviz (LOJB)
13. Miroslav Stolic (komuna e Kllokotit)
14. Marko Svilarevic (nënkryetar i komunës së Kllokotit)
15. Aleksandra Jovanovic (SPARK)
16. Danijela Mladenovic (koordinator i BSC)
17. Natalija Janicevic (asistene në BSC)
18. Vladimir Djenopoljac (ekspert)

## PROPOZIM PLANI AKSIONAL PËR IMPLEMENTIMIN E STRATEGJISË ZHVILLIMORE TË NVMS NË KOMUNËN E KLLOKOTIT, PËR VITET 2011-2016

| *N/R* | *Qëllimet strategjike* | *Emri i aktivitetit/projektit* | *Përshkrimi i aktivitetit/projektit* | *Institucioni përgjegjës* | *Viti i realizimit* | *Muaji i realizimit* | *Buxheti( €)* |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 1 | INKURAJIMI I RRITJES SË SEKTORIT TË NVMS NË KUPTIM TË RRITJES SË NUMRIT TË SUBJEKTEVE TREGTARE | Promovimi i përparësive të themelimit dhe të legalizimit të biznesit privat | Promovimi i krijimit të biznesit privat në çdo paraqitje publike nga ana e përfaqësuesve të pushtetit lokal (sektori për tregti) | Kuvendi komunal Kllokot | 2011-2016 | gjatë gjithë muajve | 0.00 |
| | | Futja e stimulimeve shtesë gjatë themelimit | Thjeshtimin shtesë të procedurave administrative nëpërmjet ofrimit të shërbimeve këshillimore, kontakti i pandërprer me subjektet tregtare duke i ofruar të gjitha informacionet e nevojshme të lidhura me biznesin | Kuvendi komunal Kllokot | 2011-2016 | gjatë gjithë muajve | 0.00 |
| | | Kredi për fillimin e biznesit privat | Të krijohet bashkëpunim me institucionet e mëdha kreditore dhe të formohet linja e veçantë për start-up (kofinansim) | Kuvendi komunal Kllokot, sektori joqeveritar | 2011-2016 | gjatë gjithë muajve | 12,000.00 |
| | | Subvencione për vetëpunësim | Dhënia e stimulimeve tatimore për 12 muajt e parë pas themelimit të biznesit (psh., të hiqet pagesa për pagimin e taksave të caktuara komunale) | Kuvendi komunal Kllokot, sektori joqeveritar | 2011-2016 | gjatë gjithë muajve | 10,000.00 |

| | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | Gara për biznes planin më të mirë | Të vendoset praktika e rregulltë në nivel vjetor për dhënien e ndihmës së pakthyeshme individëve me idenë më të mirë të biznesit të shëndrruar në një plan cilësor biznesi | Qendrave për shërbime zyrtare (QSHZ), sektori joqeveritar, donatoret | 2011-2012 | një herë në vit | 20,000.00 |
| | | Edukimi i përfaqësuesve të pushtetit lokal në sferën e ndërmarrësis, menaxhmentit, teknologjive informative, komunikimit në punë dhe finansave | Aktiviteti i përmendur do të nënkuptonte organizimin e trajnimeve profesionale për përfaqësuesit e autoriteteve lokale përgjegjëse për tregtinë në mënyrë që të jenë të gatshëm t'i japin këshilla profesionale sipërmarrësve nga fushat relavante të veprimtarisë së tyre | Kuvendi komunal Kllokot, sektori joqeveritar | 2012 | mars dhe prill | 10,000.00 |
| 2 | NGRITJA E NIVELIT TË PROFESIONALITETIT TË SIPËRMARRËSVE, PRONARËVE DHE MENAXHERËVE TË NDËRMARRJEVE TË TOGLA DHE TË MESME | Edukimi i sipërmarrësve në fushën e sipërmarrjes, menaxhmentit, marketingut, legjislaturës tatimore, finansave | Të parashihet prania e detyrueshme në edukime cilësore nga fushat me rëndësi për ndërmarrësi dhe menaxhment në sektorin NVMS | Qendrave për shërbime zyrtare (QSHZ), sektori joqeveritar, donatoret | 2011-2012 | qershor dhe korrik të secilit prej viteve të theksuara | 5,000.00 |
| | | Edukime në fushat e identifikuara si prioritete strategjike për zhvillimin e komunës | Dy herë në vitë të organizohen trajnime relavante/ seminare nga fusha e prodhimtarisë bujqësore, prodhimi dhe ambalazhimi i ujit mineral, turizmit të banjës dhe përpunimit të drurit | Qendrave për shërbime zyrtare (QSHZ), sektori joqeveritar, donatoret | 2011-2012 | mars dhe tetor të secilit prej viteve të theksuara | 15,000.00 |

| | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | Themelimi i byros sipërmarrëse | Aktiviteti nënkupton nxitjen e nismës për krijimin e një trupi brenda komunës së Kllokotit me qëllim të komunikimit të rregulltë me sipërmarrësit | Kuvendi komunal Kllokot, sektori joqeveritar | 2011 | dhjetor | 5,500.00 |
| 3 | RRITJA E INVESTIMEVE NË FUSHËN E PRODHIMTARISË BUJQËSORE ME QËLLIM TË MODERNIZIMIT TË SAJ | Subvencione për produkte të reja dhe blerjen e tokës bujqësore | Nënkupton dhënien e të gjitha lehtësimeve për sipërmarrësit të cilët kanë për qëllim të zgjërojnë prodhimtarinë e tyre, me kusht që të bashkëdorëzojnë planin përkatës të investimeve apo planin e biznesit | Kuvendi komunal Kllokot, sektori joqeveritar | 2012-2013 | në muajtë përkatës të vitit (shkaku i natyrës së produkteve bujqësore) | 20,000.00 |
| | | Subvencione për investitorët potencial | Dhënien e subvencioneve për investitorët e interesuar në kuptim të lehtësimeve tatimore për një periudhë të caktuar kohore me kusht të dorëzimit të planit investiv për më së paku 5 vjetë | Kuvendi komunal Kllokot, sektori joqeveritar | 2014-2016 | gjatë gjithë muajve | 45,000.00 |
| | | Linja kreditore për sigurimin e pajisjeve bashkëkohore të bujqësisë | Krijimi i kontaktit dhe bashkëpunimi afatgjatë me institucionet e rëndësishme kreditore me të cilat do të arrihej marrëveshja në lidhje me finansimin e këtyre gjërave | Kuvendi komunal Kllokot, sektori bankar | 2011-2013 | në muajtë përkatës të vitit (shkaku i natyrës së produkteve bujqësore) | 55,000.00 |

| | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | Promovimi i potencialit të komunës në panairet e rëndësishme të bujqësisë | Finansimi i grupeve të prodhuesve bujqësor për pjesëmarrje në panairet e mëdha bujqësore. Prezantimi i komunës së Kllokotit në panaire si vend të volitshëm për investime | Kuvendi komunal Kllokot, sektori joqeveritar | 2011-2016 | gjatë kohës deri sa mbahen panairet e përzgjedhura | 12,000.00 |
| 4 | INVESTIME PËR ZHVILLIMIN DHE MODERNIZIMIN E SEKTORIT TË TURIZMIT | Investime për analizimin e cilësisë së ujit në territorin e komunës | Angazhimi i instritucioneve respektabile të cilët mund të bëjnë analizimin cilësor të ujrave me qëllim të sertifikimit të tij | Kuvendi komunal Kllokot, sektori joqeveritar | 2012 | mars dhe prill | 5,400.00 |
| | | Subvencione për investitorët potencial në sferën e turizmit | Dhënien e subvencioneve për investitorët e interesuar në kuptim të lehtësimeve tatimore për një periudhë të caktuar kohore me kusht të dorëzimit të planit investiv për më së paku 5 vjetë | Kuvendi komunal Kllokot, sektori joqeveritar | 2011-2013 | gjatë gjithë muajve | 21,500.00 |
| | | Subvencione për vetëpunësim në sektorin e turizmit të banjës dhe në veprimtaritë përcjellëse | Ofrimin e ndimës finansiare për familjet individuale të cilat vendosin për hapjen e mini banjës individuale, me pjesëmarrje obligative të përbashkët në finansim | Kuvendi komunal Kllokot, sektori joqeveritar | 2011-2013 | gjatë gjithë muajve | 8,000.00 |
| | | Promovimi i komunës së Kllokotit si vend atraktiv për mbajtjen e konferencave, kongreseve dhe takimeve shkencore | Hartimin dhe plasimin e fushatës promovuese dhe ofertës për institucionet e tjera shkencore të cilat merren me organizimin e ngjarjeve të tilla. | Kuvendi komunal Kllokot, sektori joqeveritar | 2011-2014 | gjatë gjithë muajve | 7,500.00 |

| | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | Investimi në manifestimet tradicionale lokale | Promovimi i manifestimeve tradicionale (Petrovdan) dhe organizimi i vizitave grupore me qëllim të masovizimit të këtyre ngjarjeve. Të hartohen aranzhmane speciale për kategori të ndryshme të grupeve të interesit. | Kuvendi komunal Kllokot, sektori joqeveritar | 2011-2016 | gjashtë muaj para mbajtjes | 20,000.00 |
| | | Edukimi i popullatës lokale në fushën e turizmit të banjës | Bursa për nxënësit që mbarojnë shkollën e mesme dhe vendosin të studiojnë menaxhmentin e turizmit (hotelerinë) | Kuvendi komunal Kllokot | 2012-2013 | shtator dhe tetor të viteve të përmendura | 10,000.00 |
| | | Fushata promovuese të drejtuara kah personat zyrtarë | Nënkupton kontaktimin dhe informimin e investitorëve potencial nga të gjitha vendet në lidhje me cilësinë e resurseve ujore në territorin e komunës | Kuvendi komunal Kllokot, sektori joqeveritar | 2011-2012 | gjatë gjithë muajve | 4,500.00 |
| | | Fushata promovuese të drejtuara kah personat fizik | Promovimi i cilësisë së resurseve ujore për qëllime shëruese të sëmundjeve të caktuara, edhe ate nëpërmes TV reklamave, materialit promovues, kontakte me agjencionet turistike në rrethinë etj. | Kuvendi komunal Kllokot, sektori joqeveritar | 2011-2013 | gjatë gjithë muajve | 7,500.00 |

| | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 5 | PROMOVIMI INTENZIV I RESURSEVE UJORE SI PËRPARËSI KOMPARATIVE TË RËNDËSISHME TË TERRITORIT | Subvencione për pjesëmarrje në panaire | Dhënia e mbështetjes finansiare subjekteve tregtare të cilat mirren me përpunimin dhe ambalazhimin e ujit në kuptim të krijimit të materialit promovues për pjesëmarrje në panairet përkatëse, krijimin e web prezantimeve, marrjen me qera të paneleve etj. | Sektori joqeveritar, agjencia për mbështetjen sipërmarrësisë | 2011-2013 | në muajt kur mbahen panairet e përzgjedhur | 7,000.00 |
| | | Krijimi i web prezantimit cilësor për komunën e Kllokotit | Angazhimi i agjencioneve profesionale për krijimin e web faqes së komunës në të cilën do të promovoheshin resuset natyrore me të cilat disponon dhe me informacionet përkatëse për investitorët potencial, vizitorët dhe institucionet tjera të rëndësishme. | Kuvendi komunal Kllokot, sektori joqeveritar | 2011 | nëntor dhe dhjetor | 2,000.00 |
| | | Nxitja e themelimit të njësive të vogla prodhuese | Qëllimi është shfrytëzimi maksimal i resurseve ujore nëpërmjet subvencionimit të eksploatimit të shtuar të resurseve ujore | Kuvendi komunal Kllokot, sektori joqeveritar | 2011-2013 | gjatë gjithë muajve | 12,000.00 |

| | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 6 | NXITJA E ZHVILLIMIT TË SEKTORIT PËR KONZERVIMIN DHE PËRPUNIMIN E UJIT | Organizimi i vizitave në fabrikat e njohura për përpunimin e ujit të ambalazhuar | Duhet t'i mbledhim subjektet tregtare egzistuese nga kjo fushë dhe t'iu mundësohet që të njihen me praktikën e mirë nga kjo fushë në mënyrë që prodhimtarinë e tyre ta nxisin dhe ta zgjërojnë. | Kuvendi komunal Kllokot | 2012 | prill dhe maj | 4,000.00 |
| | | Kontaktimi me blerësit potencial | Krijimi i kontakteve me blerësit e mëdhenjë potencial të cilët në periudhën në vazhdim do të mund të figuronin si investitor në këtë territor. | Sektori i tregtisë pranë Kuvendit komunal Kllokot | 2012 | qershor-gusht | 2,000.00 |
| 7 | NXITJA E ZHVILLIMIT TË SHËNDOSH DHE ZHVILLIMIT TË PËRPUNUESVE TË VEGJËL TË DRURIT | Nxitja e themelimit të njësive të vogla prodhuese | Qëllimi është shfrytëzimi maksimal i resurseve të drurit nëpërmes subvencionimit të eksploatimit të shtuar të tij. | Kuvendi komunal Kllokot, sektori joqeveritar | 2011-2012 | gjatë gjithë muajve | 9,000.00 |
| | | Subvencionimi i veprimtarive deficitare nga kjo fushë | Drejtimin e burimeve finansiare drejtë themelimit të subjekteve tregtare në veprimtaritë të cilat nuk janë përfaqësuara aktualisht, si ofrimi i shërbimeve për varrime... | Kuvendi komunal Kllokot, sektori joqeveritar | 2012 | gjatë gjithë muajve | 6,000.00 |
| | | Pyllëzimi i territorit | Pyllëzimin e pjesëve të caktuara të territorit të komunës në mënyrë që për të ardhmen të sigurohet lënda bazë për zhvillimin adekuat të kësaj veprimtarie | Kuvendi komunal (sektori përkatës) | 2012 | gjatë gjithë muajve | 12,000.00 |

| | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | Viztimi i panaireve | Organizimin e vizitave në panairet për përpunimin e drurit me qëllim të ngritjes së vetëdijes dhe nivelit të informimit mbi trendet në këtë degë. | Kuvendi komunal (sektori përkatës) | 2011-2013 | gjatë kohës së panaireve të përzgjedhura | 5,000.00 |
| 8 | INVESTIME NË MIRËMBAJTJEN E ATYRE EGZISTUESE DHE NË NDËRTIMIN E ELEMENTEVE TË REJA TË INFRASTRUKTURËS | Investime në telekomunikacion | Rritjen e numrit të provajderëve të internetit në territorin e komunës së Kllokotit me qëllim të ngritjes së konkurrencës dhe uljes së çmimit të shërbimit të internetit | Kuvendi komunal (sektori për telekomunikacio n) | 2012-2014 | gjatë gjithë muajve | 5,000.00 |
| | | Investime në infrastrukturën rrugore | Mirëmbajtjen e infrastrukturës egzistuese dhe investimi në rregullimin e drejtimeve të reja rrugore. | Kuvendi komunal (sektori i rrugëve) | 2012-2013 | gjatë gjithë muajve | 15,000.00 |
| 9 | INVESTIME NË ARSIMIMIN E STAFIT PROFESIONAL DUKE IU PËRSHTATUR NEVOJAVE ZHVILLIMORE TË DEGËVE TREGTARE ME PRIORITET. | Dhënia e bursave për nxënësit e shkollave të mesme | Dhënia e bursave për nxënësit e mirë të cilët vendosin të studiojnë në degët e veprimtarive strategjike, me kushtin që pastaj të kthehen në Kllokot dhe të aplikojnë njohurit e fituara. | Kuvendi komunal Kllokot (sektori për arsim) | 2011-2013 | në shtator dhe tetor të viteve të theksuara | 15,000.00 |
| | | | | | | | **387,900.00** |